



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
Zyra Ligjore - Zakonodavna Kancelarija - Legal Office

Raporti për Thjeshtësimin e Lejeve dhe Licencave në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës¹

¹ Kjo analizë juridike është miratuar në Mbledhjen e 254-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 04/254 të datës 26.03.2025.

Shkurtesat:

LSLL – Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave

Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Ligji Nr. 04/L-093 për Bankat Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare

LFP – Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës

LS – Ligji Nr. 05/L -045 për Sigurimet

LPPA – Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative

Hyrje

Ky raport i mbështetur nga GIZ ka për qëllim që të pasqyrojë të gjeturat dhe rekomandimet e përgjithshme dhe konkrete për thjeshtimin e procedurave për aplikim, shqyrtim dhe pajisje për leje/licenca në Bankën Qendrore të Kosovës që rregullojnë këtë fushë apo kanë lidhshmëri sa i përket mbrojtjes së interesave publike, në raport me ligjin mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe ligjeve të veçanta që rregullojnë sistemin bankar dhe financiar. Fokus i veçantë do t'i kushtohet pjesës se si ligjvënësi i ka paraparë, përmes ligjeve në fuqi, procedurat për pajisje me leje dhe licenca, sa janë ato të favorshme për palët e interesit, a ka harmonizim në mes ligjeve përkatëse që rregullojnë këtë sferë, lehtësimet e procedurës administrative për pajisje me leje dhe licenca etj.

Në rrafshin horizontal, legjislacioni primar është **Ligji Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave (“LSLL”)**. Parimet dhe rregullat e vendosura në këtë ligj kanë për qëllim përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, në kryerjen e veprimtarive ekonomike, tregtare apo profesionale, që është e domosdoshme për të mbrojtur shëndetin publik, sigurinë publike, mjedisin dhe përdorimin e resurseve natyrore në Republikën e Kosovës². Ligj tjetër i rëndësishëm i cili ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave³, është **Ligji me Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“LPPA”)**.

Mbikëqyrjen dhe kontrollin e bankave dhe institucioneve financiare e bënë Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (“BQK”), e cila, si objektiv parësor ka të nxisë dhe të mbajë një sistem financiar stabil, duke përfshirë një sistem të sigurt, të qëndrueshëm dhe efikas të pagesave. Banka Qendrore, bazuar në nenet 11 dhe 140 të Kushtetutës dhe në bazë të dispozitave të **Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës** (më tutje **Ligji për BQK-në**), është subjekt juridik publik që ka autonomi administrative, financiare dhe menaxhuese. Ligji e përcakton BQK-në kompetente për licencimin e bankave, revokimin e licencave bankare etj., respektivisht, sipas neni 23 paragrafi 1 të Ligjit për BQK-në, e përcakton përgjegjëse ekskluzive për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare në Republikën e Kosovës. Ndërsa, kompetentë që të miratojë apo refuzojë dhëni e licencave ose të lejeve për institucionet financiare, si dhe t'i revokojë këto licenca dhe leje, është Bordi Ekzekutiv i BQK-së⁴.

Përderisa, **Ligji për Sistemin e Lejeve dhe Licencave**, në nenin 3 paragrafi 1.3 përkufizon termin “*I licencuari – personi fizik të cilit i është lëshuar një licencë profesionale*”, **Ligji për**

² Ligji NR. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, neni 1.

³ Ligji me Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 1

⁴ Ligji Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, neni 36 par. 1 nënpar. 11.

BQK-në nuk ka një përkufizim për të licencuarin, por ky ligj, ndër tjerash, në nenin 1 paragrafi 1.5 Institucionet financiare i përkufizon “*subjekte si banka, zyra të këmbimit valutor, kompani të sigurimeve, fonde pensionale si dhe subjekte të tjera që ushtrojnë aktivitete financiare, siç përcaktohet në ligje relevante për qëllimet e këtij ligji, për të cilat Bankës Qendrore i është dhënë autoritet mbikëqyrës me ligj*”.

Ligji Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare **Jo bankare** (më tutje Ligji për Banka), si ligj i veçantë, respektivisht, neni 3 i këtij ligji përkufizon se “*Licencë është autorizim i lëshuar nga BQK-ja përmes së cilës subjekti juridik e merr të drejtën për tu marrë me veprimitaritë financiare të specifikuara sipas asaj licence*”. Ky ligj përkufizon **institucionet financiare** (bankat, Institucionet Financiare Jobankare dhe Institucionet Mikrofinanciare) si **subjekte juridike**⁵, të cilat deri te marrja e licencës, i nënshtrohen disa procedurave të aplikimit duke filluar nga faza e para-aplikimit, faza e aplikimit dhe faza e pas-aplikimit.

Ligji Nr. 05/L -045 për Sigurimet (“LS”), i referohet, personave juridik të cilët licencohen për të ushtruar veprimitari të sigurimeve dhe aktivitet sigurues⁶, perderisa personat fizik janë të përcaktuar vetëm në nenin 2 të këtij ligji i cili shprehimisht përcakton se “*ky ligj zbatohet për të gjithë personat juridik dhe fizik, që ushtrojnë veprimitari të sigurimeve, risigurimeve, ndërmjetësimit në sigurime...*”, si dhe neni 4 dhe 6 të Rregullores për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime, tek kriteret për licencim, si dhe në nenin 4 të Rregullores për licencimin e trajtuesve të dëmeve në sigurime përcaktohet se “**personi fizik**” duhet t’i plotësojë kriteret si agjent në sigurime, broker në sigurime, respektivisht, trajtues i dëmeve në sigurime, të listuara në rregulloret e lartëpërmendur.

Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës (“LFP”) i cili përkufizon Menaxhuesin e mjeteve “*një fiduciar (i besuar) i cili është person juridik i licencuar nga BQK-ja...*”, Fondin pensional plotësues si “*person juridik i themeluar nga punëdhënësi apo një grup punëdhënësish për punonjësit dhe ish- punonjësit e tyre si dhe përfituesit e tyre në formë të një organi drejtues të fondit*”.⁷ Gjithashtu, edhe aktet nënligjore që rregullojnë fushën e pensioneve japid një përkufizim me të cilin termi “*I licencuari*” *nënkuption subjekt juridik i licencuar...*”⁸

Vlen të theksohet se Ligji për Banka përdor termet licencim dhe regjistrim, dhe atë në nenin 4, ky ligj përcakton përgjegjëse ekskluzive BQK-në për **dhënien e licencave** për të gjitha bankat dhe **regjistrimin** e të gjitha Institucioneve Mikrofinanciare dhe Institucioneve Financiare Jobankare për **lëshimin e lejeve** të bankave të huaja në lidhje me themelin e zyrave përfaqësuese. Për më tepër neni 10 i ligjit përcakton se “*Asnjë bankë e huaj nuk mund të themelojë dhe operojë me një zyre përfaqësuese në Kosovë pa leje nga BQK-ja*” , dhe neni 91

⁵ Ligji Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare, neni 3.

⁶ Ligji Nr. 05/L -045 për Sigurimet, neni, 1.32, 1.33, 1.34 dhe 1.35.

⁷ Ligji Nr. 04/L-101 për Fondet Pensionale të Kosovës, neni 1.

⁸ Rregullorja për licencimin e menaxhuesve të mjeteve për mjetet e fondeve pensionale për licencimin e fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësve dhe Rregullorja për licencimin e ofruesve të pensioneve plotësuese individuale.

në mënyrë taksative thekson se “*Asnjë person nuk mund të angazhohet në biznesin e një institucioni mikrofinanciar pa u regjistruar së pari në BQK sipas dispozitave të këtij ligji dhe pa qenë gjatë gjithë kohës në pajtueshmëri me këtë ligj dhe me rregulloret dhe urdhëresat në fuqi të nxjerra nga BQK-ja*”.

Në vazhdim do të fokusohemi në disa parime të cilat janë të përcaktuara në Ligjin për sistemin e lejeve dhe licencave dhe në Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative, e të cilat parime, me qëllim të lehtësimit të procedurës për paisje me leje dhe minimizimit të formaliteteve, do të duhej domosdo të jenë pjesë përbërëse edhe ligjit të BQK-së apo ligjeve dhe akteve nënligjore të nxjerra nga BQK.

Aspekti ligjor

Parimi i përcaktimit të lejeve dhe licencave me ligj. Në kuadër të Ligji për BQK, nenin 8 parografi 1, nënparografi 1.2, të ligjit janë përcaktuar detyrat e Bankës Qendrore në përmbushje e objektivave të përcaktuara, ku, ndër të tjera shpesh “**rregullimin, licencimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare ...**”. Çështja e përcaktimit të licencave, llojtit të tyre dhe emërtimit është paraparë në ligjet e veçanta dhe atë në Ligjin për Banka, Institucionin mikrofinanciare dhe Institucionin jobankare financiare, Ligjin për Fondet Pensionale dhe Ligjin për Sigurimet.

Kësisoj, nga trajtimi i licencave/lejeve (të elaboruara në pjesën vijuese), vërejmë që korpusi legjislativ në fushën e sektorit bankar është kryesisht në harmonizim me Ligjin Nr. 04/L-202 për Sistemin e Lejeve dhe Licencave, në përcaktimin ligjor (ligjeve bazike), si dhe legjislacionit sekondar që i referohet fushës përkatëse.

Afatet e licencës. Nga analiza e ligjeve vërehet se në përgjithësi licencimi i subjekteve nga BQK lëshohet për afat kohor të pacaktuar dhe licencat nuk janë të transferueshme. Përkufizimin se licenca/regjistrimi i institucioneve financiare jepet për afat kohor të pacaktuar e gjejmë në nenin 9 parografi 2, i Ligjit për Banka i cili përcakton se “**Licenca jepet me shkrim për një periudhë të pacaktuar kohe dhe nuk është e transferueshme**”. Një përkufizim të ngjashëm e gjejmë edhe tek LS⁹, si dhe në të gjitha rregulloret e nxjerra nga BQK-së të cilat përcaktojn kriteret, kërkesat, procedurat dhe afatet, që duhet ndjekur për aplikimin dhe marrjen e licencës. Tek rasti i licencimit të institucioneve financiare (bankave dhe siguruesve), vlen të theksohet fakti se, është një proces që kalon nëpër dy fazë: faza e miratimit paraprak të licencës, pas së cilës aplikanti ka në disposicion afatin prej 12 muaj nga data e miratimit paraprak për të kompletuar organizimin e bankës së re dhe faza e dytë licenca zyrtare finale pasi të përcaktohet nga BQK-ja se planet e propozuara janë realizuar.

Parimi i të drejtës në mjetet juridike. Neni 13 i Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative përcakton të drejtën e çdo personi “**që të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore... kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i**

⁹ Ligji Nr. 05/L -045 për Sigurimet, neni 6 par.4 - Licenca e lëshuar nga BQK-ja është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme.

cenon një të drejtë apo një interes juridik”. E drejta e ankesës përbënë të drejtën themelore, të garantuar edhe me Kushtetutë dhe të Drejtën Ndërkombëtare. Ligji për leje dhe licenca në nenin 27 përcakton të drejtën e ankesës ndaj vendimeve të autoritetit kompetent për refuzimin, pezullimin apo revokimin e lejimit. Megjithatë, në rastin e BQK-së, si një institucion i pavarur kushtetues e njëkohësisht edhe si autoritet që lëshon leje dhe licenca, ky institucion nuk ka një shkallë të dytë e cila do të ishte kompetente për shqyrtimin e ankesave, rrjedhimisht, ankesa në këtë rast nuk mund të përcaktohet. Gjithsesi, e drejta në mjet juridik e palëve ekziston dhe zbatohet nëpërmjet të drejtës për padi në konflikt administrativ kundër vendimit të BQK-së ai akt administrativ përfundimtar.

Edhe pse neni 87 i Ligjit për Banka ka përcaktuar se të gjitha urdhëresat dhe vendimet përfundimtare të BQK-së janë subjekt i shqyrtimit gjyqësor nga një gjykatë ose procedurë arbitrazhi në pajtim me Ligjin për Bankën Qendrore, në anën tjetër, jo në mënyrë konkrete, Ligji i BQK-së, Ligji për Banka dhe IMF e kanë të paraparë me dispozitë të veçant të drejtën e ushtrimit të ankesës. Megjithatë, sa i përket kësaj pjese duhet sqaruar faktin se në Projektligjin për Bankat i cili pritet të votohet nga Kuvendi i Kosovës, në mënyrë konkrete është adresuar çështja e “Shqyrtimeve Gjyqësore” dhe “E drejta për Mjete Juridike” nga dhe përcaktohet procedura apo mekanizmi mbrojtës që u referohet palëve në procesin përkatës.

Kësisoj Projektligji për Bankat në nenin 138 (par.1 dhe par.2) “Shqyrtimet Gjyqësore” përcakton si në vijim:

“Dispozitat e Procedurës së Përgjithshme Administrative do të zbatohen për veprimeve administrative në konflikt kundër vendimeve të nxjerra nga BQK-ja, përveç nëse përcaktohet ndryshe me këtë Ligj”.

“Urdhrat dhe vendimet përfundimtare të BQK-së ose agjentëve të saj, përfshirë çdo administrator zyrtar të emëruar nga BQK-ja, menaxher special ose likuidator, sipas këtij Ligji, do t'i nënshtronhen rishikimit gjyqësor në gjykatë ose panel të arbitrazhit në përputhje me Ligjin për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës”.

Ndërsa neni pasues i projektligjit përkatës (për Bankat), në nenin 139 (par.1) “ E drejta për Mjete Juridike” përcakton në mënyrë specifike që *“Vetëm subjekti i mbikëqyrjes mund të paraqesë kundërshtime ndaj akteve të nxjerra nga BQK-ja, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Ligj”*.

Përjashtim, sa i përket çështjes së përfshirjes së dispozitës me të cilën parashihet e drejta e ankesës kundër vendimit mbi refuzimin e kërkesë për licencë, bënë Ligji për fondin pensional, i cili ligj, në nenin 15, paragrafi 5, përcakton të drejtën e ushtrimit të ankesës dhe atë, *“Nëse BQK-ja ia refuzon kërkesën e licenës një fondi pensional, ai duhet ta njoftojë bordin e drejtoreve duke shpjeguar me shkrim arsyet për të cilat refuzohet kërkesa. Kundër vendimit për mosdhënien e licencës mund të parashtrohet ankesa në gjykatën kompetente”*. Gjithashtu, neni 19, paragrafi 3, përcakton të drejtën e fondit pensional për ushtrimin e ankesës kundër pezullimit ose anulimit të licencës nga ana e BQK-së.

Lehtësimi i procedurës së aplikimit

Kushtet dhe kriteret specifike për dhënien e licencave. Varësisht prej licencimit, BQK-ja ka përcaktuar përmes ligjeve të veçanta dhe akteve nënligjore, kushtet dhe kriteret për licencim. Këto kushte dhe kritere, nga ajo që vërehet gjatë analizimit të tyre, në disa raste mund të jenë ngarkesë për aplikuesit për licencë, pasiqë një pjesë e tyre janë lehtë të verifikueshme edhe pas fazës së shyrtimit të kërkesës për licencim, respektivisht, duke kërkuar verifikimin e disa dokumenteve që i posedojnë institucionet tjera publike, por që kërkesat e tillë mund të arsyetohen për shkak të ndjeshmërisë së kërkesave respektivisht sigurisë –stabilitetit të sektorit financiar.

Kushtet dhe kriteret për licenca të Bankave dhe IMF-ve¹⁰ janë përcaktuar në nenin 8, paragrafi 3 dhe 4 të Ligjit për Banka, ndërsa kriteret e regjistrimit të IFJB-ve janë përcaktuar në Rregulloren për Regjistrimin e Institucioneve Financiare Jobankare, respektivisht, në nenin 6 paragrafi 7.

Tek licencimi i personave juridik sipas Ligjit për Fondet Pensionale, përveç kërkesave të parapara në këtë ligj për aplikuesit për licencim si Fond Pensional (neni 15 të LFP), Ofrues të pensioneve (neni 22 të LFP) dhe Menaxhues i mjeteve (neni 10 të LFP), këto subjekte duhet plotësuar disa nga kushtet dhe kriteret kryesore të përcaktuara në Rregulloret¹¹ e veçanta të nxjerra nga BQK, duke përfshirë por mos u kufizuar në: a) të jenë të regjistruar si person juridik në pajtim me Ligjin për Shoqëritë Tregtare; b) të jenë në gjendje të mirë financiare të dëshmuar me pasqyra financiare të audituara dhe të mos ketë obligime tatimore të papaguara; c) themeluesit, drejtorët dhe menaxherët e kompanisë së propozuar të mos jenë të dënuar për ndonjë vepër penale dhe t'i plotësojnë kërkesat e BQK-së i përshtatshëm dhe i duhur.

Kushtet dhe kriteret për licencim përveç që janë përcaktuar edhe në nenin 10 të Ligjit për sigurime, kërkesat për licencë, reespektivisht, dokumentacioni i cili duhet të dorëzohet për licencim, është paraparë edhe me rregulloret e BQK-së, dhe atë në Rregulloren për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime¹², Rregulloren për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm¹³ dhe Rregulloren për licencimin e trajtuesve të dëmeve në sigurime¹⁴.

Zhvillimi i procedurës së shqyrtimit në mënyrë elektronike. Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave, në nenin 14, paragrafi 2 i këtij ligji, përcakton se “*Çdo autoritet kompetent duhet ta bëjë të mundur për një person që aplikacionin për lejim ta bëjë në mënyrë elektronike*”. Kjo çështje, në bazë të analizës së legjislacionit bazik si dhe akteve nënligjore, nuk është e rregulluar me ndonjë dispozitë që e përcakton të drejtën e të interesuarve për licencim, që aplikimin për ndonjë nga licencat e lëshuara nga BQK-ja mund ta bëjnë “vetëm” përmes formës elektronike, ashtu siç është paraparë në LSLL. BQK, përmes rregulloreve të nxjerra, që kanë të bëjnë me licencimin e personave fizik dhe juridik, udhëzon palët që aplikacionet dhe udhëzimet për plotësimin e tyre mund t'i gjejnë në ueb faqen zyrtare të BQK-së, të cilat duhet të plotësohen,

¹⁰ Shih “Kushtet për miratimin e regjistrimit”, Rregullore për regjistrimin e IMF, nenin 6, paragrafi 7, nënparagrafi 7.1

¹¹ Rregullore për licensimin e fondevë plotësuese pensionale të punëdhënësve, nenin 5; Rregullore për licencimin e ofruesve të pensioneve plotësuese individuale, nenin 5; Rregullore për licencimin e menaxhuesve të mjeteve për mjetet e fondevë pensionale, nenin 6.

¹² Rregullore për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime, nenin 4, 5, 6, 7 dhe 8.

¹³ Rregullore për licencimin e siguruesve dhe degëve të siguruesve të jashtëm, nenin 3 par. 5.

¹⁴ Rregulloren për licencimin e trajtuesve të dëmeve në sigurime, nenin 4 dhe 5.

nënshkruhen dhe në fund të dorëzohen **me prezencë fizike** së bashku me dokumentacionin e plotë i cili kërkohet me dispozita ligjore dhe rregulloreve përkatëse. Në konsideratën tonë, për shkak të specifikave që ka kjo fushë, është e kuptueshme që jo i gjithë materiali aplikues për leje/licencë të jetë vetëm në formë elektronike, për shkak të disa mekanizmave kontrollues që nevojiten të aplikohen/zbatohen gjatë këtij procesi.

Është e kuptueshme që krijimi i mundësisë së aplikimit elektronik, jo vetëm që do të ishte në pajtim edhe LSLL-në, por kjo formë do të mund të konsiderohet lehtësim në procedurat e aplikimit, pa pasur nevojë që të ndryshohet baza e ndonjë ligji përkatës, pasi që LSLL-ja, në nenin 17.2 përcakton se “**Kriteret, kërkesat, rregullat dhe procedurat lidhur me lëshimin, administrimin dhe revokimin, nëse janë të aplikueshme, e një lejimi definohen me ligj ose me akt nënligjor**”.

Lehtësimi i barrës për aplikim

Pagesa e taksave të shumëfishtha. Ligji për sistemin e lejeve dhe licencave, respektivisht, nen 18 i këtij ligji, përcakton se, taksa nuk duhet të kalojë shumën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet që i dalin autoritetit kompetent për të administruar lejimin. Çështja e pagesës së taksës në Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative është e rregulluar në atë mënyrë që përcakton se procedura administrative është pa pagesë (neni 12, paragrafi 1) dhe sipas kësaj kjo pagesë mund të bëhet vetëm në raste kur përcaktohet ndryshëm me ligj, e cila “...nuk mund të jetë më e madhe se kostoja mesatare e nevojshme për zhvillimin e llojit përkatës të procedurës administrative” (paragrafi 2).

Neni 70 i BQK-së përcakton se “**Banka Qendrore mund të caktojë tarifa dhe ngarkesa të arsyeshme për shërbimet që ofron dhe detyrat që kryen**”. Pagesën e tarifave e gjemë edhe në ligjet e veçanta dhe në aktet nënligjore të BQK-së, të cilat përcaktojnë llojet e tarifave që duhet paguar për procedurat e licencimit dhe shumën e tarifës për subjektet juridike/personat fizik në procedurën e aplikimit për marrje të licencës për të operuar në tregun vendor. Ligji për Banka, IMF dhe IFJB përcakton se “BQK-ja mund të caktojë tarifa për **procedimin** e një kërkese për licencë ose leje, **lëshimin** e licencës ose lejes dhe për **posedimin** e licencës ose lejes”¹⁵. Neni 130 i Ligjit për sigurime në paragrafin 1 përcakton tarifat të cilat duhet ti paguajnë subjektet dhe ate: tarifën e licencimit, miratimit apo autorizimit dhe, në paragrafin 2, përcakton se “**Përveç tarifës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni,..., paguajnë në BQK edhe tarifat e mbikëqyrjes**”.

Parimi i aplikimit të ndihmës administrative. Me qëllim të lehtësimit të procedurës së verifikimit të dokumenteve në rastin e aplikimit për leje dhe licenza, është i domosdoshëm që organi publik ku është parashtruar kërkesa për licencim, të aplikoj parimin e ndihmës administrative nga organet publike. Neni 34 i LPPA ka përcaktuar të drejtën e një organi publik që të kërkoj ndihmë administrative nga një organ tjeter publik, ndër të tjera edhe, ashtu siç është përcaktuar në paragrafin 2.3 “**për njohjen me fakte, dokumente apo mjete të tjera të provës në posedim të organit tjeter**”. Në procedurat e aplikimit për licenza dhe regjistrim, vërehet se BQK barrën e sigurimit të tërë dokumentacionit ia vë aplikantëve, duke e ngarkuar subjektin që

¹⁵ Ligji për Banka, IMF dhe IFJB, nen 86 par.1.

parashtron kërkesë për licencë, me procedura administrative për sigurimin e dokumenteve në organet tjera publike. Për verifikimin e disa të dhënavë, BQK-ja, mund ti aplikojë dispozitat e LPPA-së, në mënyrë që të lehtësohet procedura për palën aplikuese dhe të njëjtëtë sigurojnë vetëm dokumentacionin e domosdoshëm.

Shqyrtimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare. Ky parim është paraparë në nenin 86 të LPPA dhe i njëjti përcakton se, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj, organi publik, sipas detyrës zyrtare mund ti kërkoj palës vetëm informatat e nevojshme për identifikim, ndërsa, procedurën e administrimit të të gjitha dokumenteve, akteve...e bënë organi publik që zhvillon procedurën administrative (paragrafi 3). Ky parim mund të kuptohet edhe në lidhshmëri me parimin e ndihmës administrative, në të cilat raste organi publik gjatë zhvillimit të procedurës, shfrytëzon të drejtat që burojnë nga ligji, për sigurimin e disa akteve, dokumenteve nga organet tjera publike, që vërtetojnë pohimin e parashtruesit të kërkesës për licencim, që i njëjti posedon dokumentet e regjistrimit të aktivitetave të tij në organet publike të përcaktuara me dispozita ligjore. Në këtë rast, organi publik që zhvillon procedurën, sipas detyrës zyrtare, mund të adresojë kërkesë tek organet tjera publike për vërtetimin e fakteve apo rrethanave, me qëllim të zgjidhjes së çështjes. Tek rasti i BQK-së, ashtu siç kemi theksuar edhe më lartë, në bazë të asaj se si është rregulluar kjo çështje me dispozita ligjore dhe akte nënligjore, rezulton se, kërkesës për plotësimin e dokumentacionit me të gjitha dokumentet relevante gjatë procedurës së aplikimit, duhet ti përgjigjen aplikantët për pajisje me leje apo licencë edhe pse në disa raste, edhe pse të njëjtë do te mund të ofronin vetëm informata të nevojshme, ndërsa, sigurimin e akteve të institucioneve tjera, konsiderohet se vet BQK-ja do të mund ta bënte sipas detyrës zyrtare (siç janë Vendimet e Gjykatës për të kaluarën penale, pasqyra të ATK-së dhe Trustit Penisonal etj).

Kushtet dhe kriteret specifike për dhënien e licencave. Të gjitha kushtet dhe kriteret për dhënien e licencave janë të bazuara në dispozita ligjore dhe në rregulloret e nxjerra nga BQK. Për shkak të specifikave që lëshohen këto licenca atëherë edhe kriteret që palët e interesuara duhet t'i plotësojnë janë kritere specifike të përcaktuara në ligj apo me akt nënligjor. Duke pasur parasysh këtë fakt, rekomandohet reduktimi i dokumentacionit vetëm në ato raste kur për ndonjë nga kriteret e përcaktuara sipas dispozitave ligjore apo akteve nënligjore mund të aplikohen neni 34 paragrafi 2.3 dhe neni 86 paragrafi 3 i LPPA-së (Parimi i aplikimit të ndihmës administrative dhe Shqyrtimi i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare).

TABELA/SHTOJCA

1. Licencë për Bankat

Të gjeturat kryesore

Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Banka është një shoqëri aksionare e angazhuar në veprimtari bankare, duke përfshirë një subjekt të varur ose dege të bankës së huaj, veprimtaria apo aktivitetet e së cilës janë përcaktuar në nenin 44 të ligjit për Banka.

Baza ligjore për lëshimin e licencës është Ligji për Banka dhe aktet nënligjore të nxjerra nga BQK-ja. Procedura, kushtet dhe vendimi lidhur me licencimin e bankave janë paraparë nga nen 7 deri në nenin 14 të Ligjit për Banka, respektivisht, kushtet për tu licencuar një bankë janë përcaktuar në nenin 8 paragrafi 3 të këtij ligji dhe, për miratimin paraprak të licencës lidhur me një subjekt të varur ose degë të bankës së huaj, përveç kushteve nga paragrafi 3, duhet të plotësohen edhe kushtet nga paragrafi 4.

Procedura e licencimit të një Banke, sipas dispozitave të Ligjit për Banka, kalon nëpër tri fazë kryesore, fazë para-aplikimit, fazë e aplikimit dhe fazë pas aplikimit, ku në secilën prej tyre ekzistojnë dhe kërkohet përm bushja e disa kushteve deri në fund të procedurës për marrjen e vendimit të regjistrimit. Vendimi mbi miratimin apo refuzimin e licencimit të Bankave përcaktohet në nenin 8 paragrafin 1, sipas të cilit nen “**Brenda tre (3) muajve nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar për licencë, BQK-ja paraprakisht miraton ose refuzon atë dhe njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës për vendimin e saj**”.

Miratimi eventual paraprak i kërkesës nënkupton që, banka do të duhej që në periudhën brenda 1 viti, të përm bush të gjitha kushtet e përcaktuara nga BQK sipas nenit 8 paragrafi 5 të ligjit. Në rast se ato kushte janë përm bushur BQK do ti jap licencë dhe banka do të bëhet anëtare e Fondit për Sigurimin e Depozitave të Kosovës.¹⁶ Nëse brenda periudhës prej 1 viti, banka dështon ti’i plotësojë kushtet e parapara për fillimin e veprimtarisë, BQK ia revokon miratimin paraprak të kërkesës për licencë.

Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Pas licencimit, bankat lejohen të angazhohen në veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 44 të Ligjit për banka, dhe atë: pranimin e depozitave, blerjen dhe shitjen për llogari të vetë bankës, të letrave me vlerë, ofrimin e shërbimeve të pagesave dhe arkëtimeve, emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesave, si dhe veprimtari tjera të përcaktuara në këtë dispozitë ligjore.

Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Duke u mbështetur në nenin 9, paragrafi 2, licenca për banka jepet me shkrim për një periudhë të pacaktuar kohe dhe nuk është e transferueshme.

Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Tarifa e licencimit bankar është 10,000.00 Euro dhe është e pakompensueshme, pa marrë parasysh vendimin e BQK-së. Nëse tarifa e licencimit/regjistrimit nuk është paguar, aplikacionet konsiderohen të pa kompletuara, dhe rrjedhimisht nuk shqyrtohen.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

¹⁶ Ligji për Banka, Neni 9 paragrafi 1.

- Formulari i aplikimit; [Origjinal]
- Dokumentet përbërëse të bankës së propozuar, duke përfshirë një kopje të noterizuar apo dokumentacionin origjinal sipas të cilit është themeluar, si dhe adresën e propozuar të zyrës qendrore; [Origjinal]
- Emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet, dhe përvojën e Drejtorit apo Menaxherit të lartë të bankës së propozuar ose bankës së huaj, duke përfshirë historikun afarist dhe profesional për dhjetë (10) vitet e fundit [Kopje]
- Shumën e kapitalit të autorizuar dhe të zotuar të bankës së propozuar ose të bankës së huaj, duke përfshirë shumat të cilat janë paguar dhe burimin e ligjshëm të kapitalit; [Origjinal]
- Planin e biznesit që përfshinë, ndër të tjera, strukturën organizative të bankës së propozuar ose bankës së huaj, llojin e parashikuar të veprimitarive bankare, pasqyrat e parashikuara financiare për tri vite dhe, nëse ekzistojnë, pasqyrat financiare të audituara dhe raportet vjetore për dy (2) vitet e fundit; [Origjinal]
- Listën e aksionarëve që mbajnë apo do të mbajnë pesë (5%) përqind a më shumë të aksioneve të bankës së propozuar ose bankës së huaj, dhe pronarëve përfitues të këtyre aksioneve, duke cekur emrat e tyre, adresën dhe posedimin përkatës të aksioneve [Origjinal]
- Për çdo drejtor, aksionarët kryesor dhe menaxher të lartë të bankës së propozuar apo bankës së huaj, dëshminë zyrtare nga Gjykata që shpalos çdo dënim për vepra penale nga Gjykata penale, dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit, apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organi tjetër sipërmarrës që i është nënshtuar procedurave të paaftësisë paguese, nëse ka; [Origjinal]
- Në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës është një bankë e huaj që propozon themelin e një banke varëse ose të një dege në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga mbikëqyrësi i vendit amë se nuk ka kundërshtim rrëth fillimit të veprimitarive të propozuara në Kosovë, dhe se ushtron mbikëqyrje globale bankare të konsoliduar të veprimitarisë ndaj bankës së huaj; [Origjinal]
- Dëshminë e pagesës së tarifës për licencim; Dokumentet e kërkua të formularin për aplikim dhe informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja. [Origjinal]

2. Regjistrimi i institucioneve mikro-financiare

Të gjeturat kryesore

Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Institucion Mikrofinanciar (IMF), sipas Ligjit për Banka, është person juridik i organizuar si shoqëri aksionare sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, veprimitari primare e të cilit është dhënia e kredive dhe ofrimi i një numri të kufizuar të shërbimeve financiare për mikro dhe subjektet e vogla juridike, ekonomitë familjare me të hyra të ulëta dhe personat me të hyra të ulëta.

Sipas neni 92 të Ligjit nr. 03/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare, dispozitat e cekura në Pjesën II, nenet 7-14 të këtij ligji zbatohen edhe për

regjistrimin e institucioneve mikrofinanciare. Më konkretisht, në nenin 8 paragrafi 3 dhe 4 të këtij Ligji, janë paraparë kriteret e regjistrimit të institucioneve mikrofinaciare dhe, plotësimi i këtyre kushteve, nënkupton që BQK do të miratoj regjistrimin e IMF-së.

Procedura e regjistrimi të IMF-së kalon nëpër tri fazë, faza para-aplikimit, faze e aplikimit dhe faza pas aplikimit, ku në secilën prej tyre ekzistojnë dhe kërkohet përm bushja e disa kushteve deri në fund të procedurës përmarrjen e vendimit të regjistrimit. Vendimi mbi miratimin apo refuzimin e regjistrimit të IMF-së përcaktohet në nenin 92 paragrin 4, sipas të cilit nen “*Jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pasi që BQK-ja të ketë njoftuar aplikantin se aplikacioni për regjistrim është i kompletuar, BQK-ja nxjerr vendim me të cilin e miraton apo e refuzon regjistrimin*”. Ky afat, megjithatë sipas marrëveshjes ndërmjet BQK-së dhe aplikantit, mund të zgjatet edhe përm 90 ditë.

Miratimi eventual i kërkesës nënkupton që IMF regjistrohet përm periudhë të pacaktuar kohore, dhe, pas regjistrimit, do të duhej që në periudhën brenda 6 muajve, nga dita e njoftimit mbi regjistrimin, IMF të fillon veprimittarinë. Me rastin e regjistrimit në BQK, IMF-të angazhohen në të gjitha aktivitetet e lejuara sipas nenit 93 të Ligjit nr. 03/L-093. Nëse brenda gjashtë muajve, ashu siç u theksua më parë, IMF dështon apo nuk e fillon veprimittarinë, regjistrimi bëhet i pavlefshëm¹⁷.

Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Veprimitaria primare e IMF-së është dhënia e kredive dhe ofrimi i një numri të kufizuar të shërbimeve financiare për mikro dhe subjektet e vogla juridike, ekonomitë familjare me të hyra të ulëta dhe personat me të hyra të ulëta, siç është përcaktuar në nenin 93 të Ligjit për Banka. Ky nen në paragrin 3.7, parashev si të drejtë të rezervuar të BQK-së që përmes vendimit dhe arsyetimit me shkrim, “*...ta ndalojë ose kufizojë çdo institucion të regjistruar mikrofinanciare në angazhimin në ndonjë nga aktivitetet e lejuara të përcaktuara në këtë nen të këtij ligji*”. Vendimi i BQK-së përm ndalim dhe kufizim të aktivitetave të lejuara të IMF-ve, do të duhej të plotësohej edhe me një dispozitë apo paragraf shtesë, i cili do t'u mundëson palëve që të paraqesin kundërshtimet e tyre apo ankesën përm ndalim dhe kufizim të ushtrimit të aktivitetave të parapara me dispozita të këtij ligji.

Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Regjistrimi i institucionit mikrofinanciar, bazuar në nenin 92 parafrati 5 të Ligjit për Banka, IMF dhe IFJB, miratohet përm një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk mund të transferohet.

Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Tarifa e regjistrimit të IMF-është pesë mijë (5,000.00) Euro dhe është e pakompensueshme, pa marrë parasysh vendimin e BQK-së. Nëse tarifa e licencimit/regjistrimit nuk është paguar, aplikacionet konsiderohen të pa kompletuara, dhe rrjedhimisht nuk shqyrtohen.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

¹⁷ Ligjit nr. 03/L-093, nen 92 par. 5.

- Formulari i aplikimit; [Origjinal]
- Dokumentet përbërëse të IMF-së së propozuar, duke përfshirë një kopje të noterizuar apo dokumentacionin origjinal sipas të cilit është themeluar, si dhe adresën e propozuar të zyrës qendrore; [Origjinal]
- Emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet, përvojën dhe historikun afarist e profesional të çdo drejtori, aksionari kryesor dhe menaxheri të lartë të IMF-së së propozuar, duke përfshirë historikun afarist dhe profesional për dhjetë (10) vitet e fundit; [Origjinal]
- Shumën e kapitalit të autorizuar dhe të zotuar të IMF-së së propozuar, duke përfshirë shumat të cilat janë paguar dhe burimin e ligjshëm të kapitalit; [Origjinal]
- Planin e biznesit që përfshinë, ndër të tjera, strukturën organizative të IMF-së së propozuar, llojin e parashikuar të veprimtarive, pasqyrat e parashikuara financiare për tri vite dhe, nëse ekzistojnë, pasqyrat financiare të audituara dhe raportet vjetore për dy (2) vitet e fundit; [Origjinal]
- Listën e aksionarëve që mbajnë apo do të mbajnë pesë (5%) përqind a më shumë të aksioneve të IMF-së së propozuar dhe pronarëve përfitues të këtyre aksioneve, duke cekur emrat e tyre, adresën dhe posedimin përkatës të aksioneve; [Kopje]
- Për çdo drejtor, aksionar kryesor, dhe menaxher të lartë të IMF-së së propozuar, dëshminë zyrtare nga Gjykata që shpalos çdo dënim për vepra penale nga Gjykata penale, dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit, apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organi tjetër sipërmarrës që i është nënshtuar procedurave të paaftësisë paguese, nëse ka; [Origjinal]
- Në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës është një institucion financiar i huaj që propozon themelimin e një IMF-je varëse në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga mbikëqyrësi i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të veprimtarive të propozuara në Kosovë, dhe se ushtron mbikëqyrje globale financiare të konsoliduar të veprimtarisë ndaj IMF-së së huaj, nëse është e aplikueshme; [Origjinal]
- Dëshminë e pagesës së tarifës për regjistrim; [Origjinal]

3. Regjistrimi i institucioneve financiare jobankare

Të gjeturat kryesore

Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Institucion financiar jobankar (IFJB) është person juridik që nuk është bankë e as institucion mikrofinanciar, që është regjistruar nga BQK-ja sipas Ligjit për Bankat, IMF dhe IFJB, për t'u angazhuar në një ose më tepër nga veprimtaritë vijuese: dhënen e kredive, hyrjen në hua dhe kontrata qiradhënieje financiare-lizingu, në nënshkrimin, tregtimin, ndërmjetësimin ose shpërndarjen e letrave me vlerë, veprimin si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve apo ofrimin e shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutor; kredit kartat; faktoringun ose garancitë, ose shërbime të tjera financiare, edukuese-trajnuese, këshillëdhënëse dhe operacionale, si dhe veprimitari të tjera sipas përcaktimit nga BQK-ja.

Neni 92 të Ligjit nr. 03/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare, përcakton se, dispozitat e cekura në Pjesën II, nenet 7-14 të këtij ligji zbatohen edhe për regjistrimin e institacioneve financiare jo bankare. Gjithashtu, kriteret e regjistrimit të Institucioneve Financiare Jo bankare (IFJB) janë përcaktuar në nenin 7, paragrafi 1 të Rregullores për Regjistrimin, Mbikëqyrjen dhe Veprimtaritë e Institucioneve Financiare Jo bankare, përbushja e të cilave rezulton me miratimin për regjistrim nga BQK.

Procedura e regjistrimi të IFBJ-së kalon nëpër tri fazë, faza para-aplikimit, faze e aplikimit dhe faza pas aplikimit, ku në secilën prej tyre ekzistojnë dhe kërkohet përbushja e disa kushteve deri në fund të procedurës përmarrjen e vendimit të regjistrimit. Vendimi mbi miratimin apo refuzimin e regjistrimit të IFBJ-së përcaktohet në nenin 92 paragrin 4, sipas të cilit nen “*Jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë pasi që BQK-ja të ketë njoftuar aplikantin se aplikacioni për regjistrim është i kompletuar, BQK-ja nxjerr vendim me të cilin e miraton apo e refuzon regjistrimin*”. Ky afat, megjithatë sipas marrëveshjes ndërmjet BQK-së dhe aplikantit, mund të zgjatet edhe për 90 ditë.

Miratimi eventual i kërkesës nënkuption që IFBJ regjistrohet për periudhë të pacaktuar kohore dhe, pas regjistrimit, do të duhej që në periudhën brenda 6 muajve, nga dita e njoftimit mbi regjistrimin, IFBJ të fillon veprimtarinë. Me rastin e regjistrimit në BQK, IFJB-të angazhohen në të gjitha aktivitetet e lejuara sipas nenit 94 të Ligjit nr. 03/L-093. Nëse brenda gjashtë muajve, ashu siç u theksua më parë, IFBJ dështon apo nuk e fillon veprimtarinë, regjistrimi bëhet i pavlefshëm¹⁸.

Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Neni 96 i Ligjit për Banka, përcakton se “*Veprimtaritë e një institucioni mikrofinanciar dhe një institucioni jobankar financiar qeverisen dhe menaxhohen nga dhe nën drejtimin e organeve të veta ekzekutive, në pajtim me këtë ligj dhe me statusin ligjor të institucionit*”.

Veprimtaritë financiare të lejuara për IFJB-të janë përcaktuar në nenin 94 të Ligjit nr. 03/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jo bankare¹⁹, ku përfshihen dhënia e kredive, lidhja e marrëveshjeve për hua dhe qira, nënshkrimi, tregimi i letrave me vlerë; veprimi si shoqëri investuese ose këshilltar i investimeve; apo ofrimi i shërbimeve të tjera financiare siç janë këmbimi valutor; kredit kartat; faktor ringun ose garancitë ose shërbime të tjera financiare, informative, këshillëdhënëse dhe operacionale (paragrafi 1) si dhe në aktivitetetë tjera të përcaktuara në paragrin 2 të nenit 94. Për dallim nga institucionet tjera, IFJB-të angazhohen vetëm në ato veprimtari për të cilat ka miratim në BQK.²⁰ Me kalimin e kohës, IFJB-të mund të kërkojnë miratim në BQK për ushtrimin e veprimtarive shtesë.

Neni 94 në paragrin 5 të Ligjit, parashev si të drejtë të rezervuar të BQK-së që përmes vendimit dhe arsyetimit me shkrim, “*...t’ia ndalojë ose kufizojë çdo institucion jobankar financiare angazhimin në ndonjë nga aktivitetet e lejuara të përcaktuara në këtë nen të këtij ligji*”. Vendimi i BQK-së për ndalim dhe kufizim të aktiviteteve të lejuara të IMF-ve, do të duhej

¹⁸ Ligjit nr. 03/L-093, nen 92 par. 5.

¹⁹ Shih edhe “Rregullore për regjistrimin e Institucionet Financiare Jobankare”, nen 3.

²⁰ Rregullore për regjistrimin e Institucionet Financiare Jobankare, nen 10.

të plotësohej edhe me një dispozitë apo paragraf shtesë, i cili do t'u mundëson te palëve që të paraqesin kundërshtimet e tyre apo ankesat për ndalim dhe kufizim të ushtrimit të aktivitetave të parapara me dispozita të këtij ligji.

Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Regjistrimi Institucion Financiar Jo bankar, bazuar në nenin 92 paragrafi 5 të Ligjit për Banka, IMF dhe IFJB, miratohet për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk mund të transferohet.

Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Tarifa e regjistrimit të IFBJ- është pesë mijë (5,000.00), me përjashtim nga ky rregull kanë rastet kur aplikohet për regjistrim si Institucion Financiar Jobankar me aktivitet të vetëm këmbimin valutor e cila është dy mijë e pesëqind (2,500.00) Euro. Pagesa është e pakompensueshme, pa marrë parasysh vendimin e BQK-së. Nëse tarifa e licencimit/regjistrimit nuk është paguar, aplikacionet konsiderohen të pa kompletuara, dhe rrjedhimisht nuk shqyrtohen.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Formulari i aplikimit; [Origjinal]
- Certifikata e regjistrimit të biznesit; [Kopje]
- Biznes planin duke përfshirë veprimtarinë bankare dhe pasqyrat e planifikuara për tri vite [Origjinal]
- Kopje e politikave dhe procedurave të Institucionit; [Origjinal]
- Listën e tarifave për ofrimin e shërbimeve të planifikuara; [Origjinal]
- Dokumentacioni për shfrytëzimin e sistemit operativ të teknologjisë informative; [Origjinal]
- Deklaratë nga mbikëqyrësi i jashtëm që e aprovon për themelimin e Institucionit në Kosovë, nëse institucioni është i mbikëqyrur jashtë Kosovë [Origjinal]
- Informata për kapitalin e zotuar dhe të autorizuar;

4. Licencë për menaxhuesit e mjeteve pensionale - Licencë për menaxhuesit e mjeteve të fondeve pensionale

Të gjeturat kryesore

Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Sipas përkufizimit nga neni 1, të Ligjit nr. 04/L-101 për fonde pensionale, menaxhues i mjeteve nënkupton “*një fiduciar (i besuar) i cili është person juridik i licencuar nga BQK-ja ose nga ndonjë organ tjetër rregullues i tregut të kapitalit në Kosovë (ose trashëguesi i tij) ose nga një organ i tregjeve të kapitalit të shteteve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik që investon apo i menaxhon mjetet ose siguron këshilla lidhur me investimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për një Fond pensional plotësues të punëdhënësit ose për një Fond plotësues individual në bazë të marrëveshjes për menaxhimin e mjeteve*”.

Baza ligjore për licencimin e menaxhuesit të mjeteve është nen 10 i Ligjit për fonde pensionale dhe Rregullorja e BQK-së për licencimin e menaxhuesve të mjeteve për mjetet e fondeve pensionale. Neni 6 i Rregullores për licencimin e menaxhuesve të mjeteve për mjetet e fondeve pensionale përcakton kriteret për licencim, ndërsa sipas nenit 9, paragrafi 2 të kësaj rregulloreje, ***“BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon kërkesën për licencë si menaxhues i mjeteve pensionale brenda 90 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për licencë”***.

Kjo licencë jepet për periudhë të pacaktuar dhe nuk është transferueshme dhe nëse brenda (12) muajve nga data e licencimit, menaxhuesi i mjeteve nuk e fillon veprimtarinë, licenca do të revokohet.

Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Përderisa nen 2 i LFP, përkufizon se “Menaxhuesi i mjeteve” është përsuni juridik i licencuar që “...investon apo i menaxhon mjetet ose siguron këshilla lidhur me investimet e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, për një Fond pensional plotësues të punëdhënësit ose për një Fond plotësues individual në bazë të marrëveshjes për menaxhimin e mjeteve”, veprimitaria për të cilën lëshohet licenca është rregulluar në nenin 8 të LFP-së dhe Rregullorja për për licencimin e menaxhuesve të mjeteve për mjetet e fondeve pensionale. Neni 2 i kësaj rregullore përcakton se termi “Menaxhimi i Mjeteve” nënkuption drejtimin, investimin, riinvestimin, strukturimin, ristrukturimin, përvetësimin, shitjen, transferimin ose bartje tjetër të mjeteve të pensioneve dhe interpretimin e këshillës në lidhje me këtë.

Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Licenca jepet me shkrim për një periudhë të pacaktuar kohore dhe nuk është e transferueshme.

Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Tarifa e aplikimit për licencë është dhjetë mijë (10,000.00) Euro dhe kjo tarifë e aplikimit nuk rimbursohet edhe në rast të refuzimit të kërkesës për licencë nga BQK-ja.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Formulari i aplikimit; [Origjinal]
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe statutin; [Origjinal]
- Biografitë e plota të themeluesve, si dhe pasqyrat financiare nëse janë të aplikueshme; [Kopje]
- Listën e anëtarëve të propozuar për bordin e drejtoreve dhe menaxherëve, biografitë e plota të tyre, duke përfshirë dëshmitë, që vërtetojnë përgatitjen dhe përvojën relevante; [Origjinal]
- Struktura organizative (organogrami); [Origjinal]
- Plani i biznesit; [Origjinal]
- Dokumenti që vërteton se Menaxhuesi i Mjeteve i propozuar disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimitarinë si Menaxhues i mjeteve

pensionale, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizuar të raportimit të të dhënave në BQK; [Origjinal]

- Lista e bankave dhe adresat e tyre me të cilat aplikuesi ka aranzhime bankare dhe përshkrimi i shkurtër i aranzhimeve të tilla [Origjinal]
- Dëshmi e pagesës së tarifës së aplikimit për licencë; [Origjinal]
- Dëshmi që vërteton pagesën e kapitalit minimal të kërkuar sipas kësaj Rregullore; [Origjinal]

5. Licencimi dhe rregullimi i fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësit

Të gjeturat kryesore

Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Fondet Plotësuese Pensionale të Punëdhënësit është fond vullnetar ku punëdhënësit mund të sigurojnë për punonjësit e tyre pensione plotësuese, mjetet e të cilave nuk mund të tërhiqen deri në moshën e pensionimit.

Baza ligjore për licencimin dhe rregullimin e pensioneve plotësuese të punëdhënësit është Ligjit për fondet pensionale, neni 15 i këtij ligji, i cili përcakton se përveç rasteve kur pensioni paguhet nga një fond i licencuar, të drejtën e pagesës, reklamimit dhe premtimit të tij nuk e kanë asnë person fizik apo juridik i palicencuar.

Gjithashtu, BQK-ja, ka nxjerr Rregullore që e mbulojnë fushën e licencimit dhe rregullimit të fondeve plotësuese, siç është Rregullorja për licensimin e fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësve, në të cilën janë përcaktuar kriteret bazë për licencim (neni 5) që duhet plotësuar me rastin e kërkesës për licencim, dhe atë: regjistrimi si person juridik sipas Ligjit për Shoqërit Tregtar, gjendja e mirë financiare dhe pa obligime të papaguara tatimore dhe e fundit themeluesit, drejtorët dhe menagjerët të mos jenë të dënuar për ndonjë vepër penale si dhe t'i plotësojnë kushtet e BQK-së.

Veprimtaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Bazuar në nenin 14 të Ligjit për Fonde Pensionale, Punëdhënësit mund të sigurojnë pensione plotësuese të punëdhënësit nëpërmjet krijimit të fondeve plotësuese pensionale të punëdhënësit (“fonde pensionale”). Licenca, sipas ligjit, jepet në bazë të kërkesës së fondit pensional (neni 15, paragrafi 2), ku pas marrjes së licencës fondi fiton të drejtën për të bërë **“marrëveshje me mbajtësin dhe me çdo menaxhues të mjeteve apo me instrumentin për investime të hapura, si dhe të fillojë me pranimin e kontributeve”**.

Veprimtaria e Fondi, bazuar në LFP, fokusohet në dy drejtime, Realizimi i investimeve nga fondet plotësuese pensionale të punëdhënësit, ku, fondi pensional, sipas vendimit të bordit të drejtorëve, zgjedhë një ose më shumë menaxhues të mjeteve apo instrumente për investime të hapura për të qeverisur një pjesë ose të gjitha mjetet e fondit pensional (neni 16, par.4) dhe Ruajtja e fondeve të pensioneve plotësuese të punëdhënësit, e cila realizohet kur, fondi pensional në bazë të vendimit të bordit të drejtorëve, e zgjedh mbajtësin e mjeteve të pensionit për mjetet pensionale të investuara nga menaxhuesi i mjeteve (neni 17, par.1).

Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Licenca jepet me shkrim për një periudhe të pacaktuar kohore, dhe nuk është e transferueshme. Nëse brenda 12 muajve nga data e licencimit, Fondi Pensional nuk e fillon veprimtarinë, licenca do të revokohet.

Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Tarifa e regjistrimit varësisht nga numri i pjesëmarrësve në fond: 0 - 200 pjesëmarrës 1,500.00 EUR 201 - 500 pjesëmarrës 2,500.00 EUR 501 - 1000 pjesëmarrë 5,000.00 EUR mbi 1000 pjesëmarrës 10,000.00 EUR

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Aktin themelues me të cilin themelohet Fondi pensional; [Origjinal]
- Aktet normative të Fondit pensional që specifikojnë detajet e pagesës së kontributeve dhe të benefacioneve me kategoritë e punonjësve përkatës; [Origjinal]
- Marrëveshjen e propozuar me mbajtësin; [Origjinal]
- Listën e nënshkruesve të aktit themelues së bashku me informacionin që tregon nëse ata persona janë të ndëlidhur dhe llojin e ndërlidhjeve të tyre; [Origjinal]
- Dokumentet e Fondit pensional që i përdorin pjesëmarrësit dhe përfituesit; [Origjinal]
- Deklaratat nga anëtarët e këshillit të drejtoreve që ata pajtohen t'i kryejnë këto funksione si fiduciarë dhe të plotësojnë kërkesat që parashtrohen me Ligj; [Kopje]
- Konkluzionet e një eksperti të pavarur që konfirmon ekzistencën e vlerësimit dhe vërteton se kontributet e kërkua janë adekuate për të paguar pensionet, në rast të Fondit të Pensioneve me Benefit të Definuar; [Origjinal]
- Formulari i BQK-së (aplikacioni); [Origjinal]
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit; [Origjinal]
- Biografitë e plota të themeluesve, anëtarëve të bordit drejtues dhe menaxherëve te saj si dhe pasqyrat financiare, [Origjinal]
- Listën e anëtarëve të propozuar për bordin e drejtoreve dhe menaxherëve, biografitë e plota të tyre, duke përfshirë dëshmitë që vërtetojnë përgatitjen dhe përvojën relevante; [Origjinal]
- Statutin; [Origjinal]
- Struktura organizative (organogramin); [Origjinal]
- Plani i biznesit; [Origjinal]
- Statutin e Sponsorit ose Sponsorëve; [Origjinal]
- Lista e pjesëmarrësve që tregojnë kategoritë e tyre profesionale, ose deklaratat e të gjithë nëpunësve të Sponsorit që do të marrin pjesë; [Kopje]
- Kopja e marrëveshjes së propozuar me Menaxhuesin e licencuar të mjeteve të pensioneve; [Kopje]
- Listën e bankave dhe adresat e tyre me të cilat Sponzori(ët) ka aranzhime bankare dhe për të cilat Fondi Pensional i propozuar pretendon të këtë aranzhime bankare, dhe përshkrimi për aranzhime të tillë; [Kopje e verifikuar]
- Kopja e marrëveshjes së propozuar për mbajtjen e mjeteve me mbajtësin e licencuar; [Kopje]

- Emri dhe detajet kontaktuese të firmës audituese për Fondin Pensional; [Origjinal]
- Dokumenti që vërteton se Fondi Pensional i propozuar disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimtarinë si Fond Pensional, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizuar të raportimit të të dhënave në BQK; [Origjinal]
- Dëshmi të pagesës së tarifës së licencës në bazë të numrit të pjesëmarrjeve; [Origjinal]
- Dokumente të tjerë që nevojiten sipas rregulloreve ose kërkesave të BQK-së; [Origjinal]

6. Licencë për Pensione Plotësuese Individuale - Licencë për fondet pensionale plotësuese individuale

Të gjeturat kryesore

Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Fondet pensionale plotësuese individuale janë fond vullnetar përmes të cilave, individët mund të sigurojnë pensione plotësuese individuale përmes pensioneve plotësuese individuale, mjetet e të cilave nuk mund të tërhiqen deri në moshën e pensionimit.

Baza ligjore për licencimin dhe rregullimin e pensioneve plotësuese të punëdhënësit eshtë Ligjit për fondet pensionale, respektivisht, neni 22 i këtij ligji, dhe rregulloret e nxjerra nga BQK-ja, në të cilat përkatohen kushtet, procedurat, afatet për aplikimin dhe dhënien e licencës. Neni 22 i LFP-së përcakton se ssnjë pension nuk mund të paguhet, të reklamohet apo të premtohet nga ndonjë person fizik a juridik përveç ofruesit të pensioneve i cili më parë eshtë licencuar nga BQK.

Rregullorja për për licencimin e ofruesve të pensioneve plotësuese individuale përkufizon nacionin “Pension plotësues individual” – sipas të cilit nënkuftohet **“një pension për një person individual fizik i blerë nga ofruesi i pensioneve siç eshtë një institucion finanziar, bankë, menaxhues i mjeteve, instrument për investime të hapura ose kompani e sigurimeve dhe i sigruar sipas këtij ligji”**. Gjithashtu, përmes kësaj rregulloreje janë përcaktuar kriteret bazë për licencim (neni 5) që duhet plotësuar me rastin e kërkesës për licencim, dhe atë: regjistrimi si person juridik sipas Ligjit për Shoqërit Tregtare, gjendja e mirë financiare dhe pa obligime të papaguara tatimore dhe e fundit themeluesit, drejtoret dhe menagjerët të mos jenë të dënuar për ndonjë vepër penale si dhe t'i plotësojnë kushtet e BQK-së.

Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licanca:

Bazuar në nenin 21 të Ligjit për Fonde Pensionale, Ofruesi i pensioneve (institucionet financiare, instrumentet për investime të hapura, bankat dhe kompanitë e sigurimit), mund të ofrojë pensione plotësuese individuale me kërkesë të personit fizik vetëm në bazë të licencës së BQK-së. Me rastin e marrjes së licencës, ofruesi i pensioneve të pensionit plotësues individual mund të bëjë një marrëveshje me mbajtësin dhe me çdo menaxhues të mjeteve dhe më pas të fillojë pranimin e e kontributeve.

Gjithashtu, edhe Rregullorja për licencimin e ofruesve të pensioneve plotësuese individuale në nenin 3, paragrafi 1, “Veprimitaria e Ofruesve të Pensioneve Plotësuese Individuale”, përcakton

institucionet financiare si ofrues tē vetēm tē pensioneve plotësuese individuale, ndërsa, nē nenin 2 përcakton se me pension plotësues individual nënkuptohet “*një pension për një person individual fizik i blerë nga ofruesi i pensioneve siç është një institucion financiar, bankë, menaxhues i mjeteve, instrument për investime tē hapura ose kompani e sigurimeve dhe i siguruar sipas këtij ligji*”.

Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Licenca jepet me shkrim për një periudhe tē pacaktuar kohore, dhe nuk është e transferueshme. Nëse brenda 12 muajve nga data e licencimit, Ofruesi i Pensioneve nuk e fillon veprimtarinë, licenca do tē revokohet.

Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Tarifa e regjistrimit varësisht nga numri i pjesëmarrësve në fond: 0 - 200 pjesëmarrës 1,500.00 EUR 201 - 500 pjesëmarrës 2,500.00 EUR 501 - 1000 pjesëmarrë 5,000.00 EUR mbi 1000 pjesëmarrës 10,000.00 EUR.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Aktin themelues që themelon subjektin juridik i cili ofron pensionin; [Origjinal]
- Rregullat e pensionit që specifikojnë detajet e pagesës së kontributeve ose tē benificioneve dhe rregullat përfundimin apo anulimin e parakohshëm, nëse ka; [Origjinal]
- Marrëveshjen e propozuar me mbajtësin ose drejtorin e mjeteve, nëse ka; [Kopje]
- Listën e nënshkruesve tē aktit themelues së bashku me informacionin që tregon nëse ata janë persona tē ndërlidhur dhe llojin e ndërlidhjeve tē tyre; [Origjinal]
- Formularët e pensionit që i përdorin pjesëmarrësit dhe përfituesit; [Origjinal]
- Deklaratat nga anëtarët e organit qeverisës tē siguruesit tē pensioneve se ata pranojnë tē veprojnë si fiduciarë dhe i plotësojnë kërkesat e paraqitura në këtë ligj; [Origjinal]
- Formulari i BQK-së; [Origjinal]
- Kopja e licencës dhe regjistrimit si institucion financiar; [Kopje e verifikuar]
- Biografitë e plota tē themeluesve, si dhe pasqyrat financiare nëse janë tē aplikueshme; [Origjinal]
- Listën e anëtarëve tē propozuar për bordin e drejtoreve dhe menaxherëve, biografitë e plota tē tyre, duke përfshirë dëshmitë që vërtetojnë përgatitjen dhe përvojën relevante; [Origjinal]
- Struktura organizative (organogramin); [Origjinal]
- Statutin; [Origjinal]
- Kopjen e regjistrimit tē biznesit si ofrues i pensioneve; [Kopje]
- Plani i biznesit; [Origjinal]
- Plani pensional; [Origjinal]
- Opinionin e një eksperti tē pavarur/aktuarit që konfirmojnë ekzistencën e vlerësimit dhe vërtetojnë se kontributet e kërkua janë adekuate për tē paguar pensionet, në rast tē Fondit të Pensioneve me Benefit tē Definuar; [Origjinal]
- Përshkrimi i kategorive tē pensioneve që do tē ofrojë në treg, dhe kopja e kontratës (ve) individuale tē pensionit ose dokument (të) ekivalente që evidentojnë pjesëmarrjen e individit; [Origjinal]

- Pasqyrë mbi sistemin e menaxhimit te rrezikut e siguruar nga ofruesit e pensioneve për funksionimin e biznesit të pensioneve [Origjinal]
- Raport të ofruesit të pensioneve për politiken e investimeve; [Origjinal]
- Lista e pjesëmarrësve që tregojnë kategoritë e tyre profesionale, ose deklaratat e të gjithë nënpunesave të Sponsorit që do të marrin pjesë; [Origjinal]
- Dokumenti që vërteton se ofruesi i pensioneve i propozuar disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimitarë si Fond Pensional, përfshirë edhe instalimin e sistemit të informatizuar të raportimit të të dhënave në BQK; [Origjinal]
- Dëshmi të pagesës së tarifës së licencës në bazë të numrit të pjesëmarrjeve; [Origjinal]

7. Licencë për Ndërmjetësues të Sigurimeve

Të gjeturat kryesore

Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Dispozitat ligjore të Ligjit për Sigurimet si dhe aktet nënligjore të BQK-së, përbëjnë bazën kryesore të legjisacionit me anë të së cilës është bërë rregullimi i fushës së sigurimeve në aspektin e lëshimit të licencave për personat fizik dhe juridik. Ligji për sigurimet në nenin 4, paragrafi 2, përcakton përgjegjësinë ekskluzive të BQK-së për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e siguruesve dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, si dhe shprehimisht thekson se vetëm personat që janë të licencuar dhe kanë aprovim të vlefshëm për ndërmjetësimin e sigurimeve, mund të merren me këtë veprimitari (neni 5, par.1).

Ashtu siç theksuam më lartë, baza ligjore për licencim është përcaktuar në Ligjin për Sigurimet dhe Rregulloren për Licencimin e Ndërmjetësuesve në Sigurime (më tej Rregullore). Nëse BQK-ja konstaton se janë plotësuar kushtet e parapara me Ligjin për Sigurimet dhe Rregullore, BQK-ja merr vendim për miratimin e licencës për ndërmjetësues, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Sigurimet, respektivisht nenin 112 të këtij ligji dhe nenin 5 të Rregullores për licencimin e kompanive ndërmjetësuese, nenin 114 të Ligjit dhe nenin 7 të Rregullores për licencimin e brokerëve, nenin 8 të Rregullores për licencimin e degëve të kompanive të jashtme ndërmjetësuese, nenin 10 dhe 11 të Rregullores për licencimin e ndërmjetësimit në sigurime si aktivitet shtesë (banka dhe agjpcionet e udhëtimi).

Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Veprimitaria kryesore për të cilën lëshohet kjo licencë është ushtrimi i aktivitetit të ndërmjetësimit në sigurime. Neni 110 paragrafi 1 i LS-së, përcakton “*Ndërmjetësues në sigurime është personi fizik apo juridik i kontraktuar nga siguruesi dhe i licencuar nga BQK-ja, për të ushtruar veprimitari të ndërmjetësimit të sigurimeve...*”, për të vazhduar me praragrin 2 që specifikon llojin e veprimitarisë së ndërmjetësuesve në sigurime dhe dy kategoritë e tyre, varësisht nga fakti nëse ata veprojnë kryesisht në llogari të siguruesve apo në në llogari të të siguruarve. Përkufizim të ngjashëm për ndërmjetësuesit e gjejmë edhe në rregulloren për licencimin e ndërmjetësuesve në sigurime, sipas të cilit me termin ndërmjetës në

sigurime nënkupton, “*personin fizik apo juridik i licencuar nga BQK-ja dhe i kontraktuar nga siguruesi për të ushtruar veprimitari të ndërmjetësimit në sigurime*”.

Sipas nenit 120 të LS-së “*Veprimitaria e ndërmjetësuesve në sigurime mund të ushtrohet nga kompani të agjentëve dhe kompani të brokerimit, me seli në Republikën e Kosovës, të licencuara të ushtrojnë veprimitari ndërmjetësimi në sigurime*”.

Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Licenca jepet me shkrim për një periudhe të pacaktuar kohore.

Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Tarifa e regjistrimit: Pagesë për marrjen e licencës: Licencë e kompanisë së brokerimit 5,000.00 € Licencë e kompanisë së agjentëve 3,000.00 € Licencë e kompanisë për trajtimin/vlerësimin e dëmeve 3,000.00 €

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Formulari i aplikimit; [Origjinal]
- Dokumentet përbërëse të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar, duke përfshirë kopje të noterizuar të dokumentacionit origjinal sipas të cilit është themeluar, si dhe adresën e propozuar; [Kopje e verifikuar]
- Emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet, përvoja dhe referencat përcjellëse si dhe kopja e dokumentit identifikues të drejtoreve (nëse është e aplikueshme) dhe menaxherëve të lartë të kompanisë së propozuar, si dhe të së paku një agjenti respektivisht brokeri të licencuar nga BQK-ja; [Kopje]
- Dëshmi zyrtare nga gjykata kompetente, që shpalos çdo dënim eventual për vepra penale dhe çdo procedurë penale për aksionarët, drejtoret (nëse është e aplikueshme) dhe menaxheret e lartë të propozuar; [Origjinal]
- Formulari zyrtar i BQK-së përmes të cilit autorizojnë BQK-në që të kërkoj informacione nga institucionet kompetente me qëllim të verifikimit të të kaluarës së tyre penale për çdo drejtor (kur është e aplikueshme) dhe menaxher të lartë të kompanisë së propozuar; [Origjinal]
- Dokument që dëshmon shumën e kapitalit të zotuar të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar, duke përfshirë të dhëna për burimin e atij kapitali; [Kopje e verifikuar]
- Plani i biznesit që përfshinë, ndër të tjera, strukturën organizative të kompanisë ndërmjetësuese të propozuar, pasqyrat e parashikuara financiare për tri (3) vite, dhe nëse ekzistojnë pasqyrat financiare të audituara të aksionareve për tri (3) vitet e fundit; [Origjinal]
- Para-kotrata me siguruesin në llogari të së cilit do të zhvilloj aktivitetin- për kompanitë e agjentëve; [Origjinal]
- Dokument - Marrëveshja e qirasë dhe njoftimi-forma për plotësimin e kushteve teknike që vërteton se kompania ndërmjetësuese disponon mjedisin dhe infrastrukturën e përshtatshme për të ushtruar veprimitarinë; [Origjinal]

- Në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës, është një institucion financiar i jashtëm që propozon themelimin e një kompanie ndërmjetësuese varëse në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga mbikëqyrësi i vendit amë se nuk ka kundërshtim rrëth fillimit të aktiviteteve të propozuara në Kosovë, (nëse kërkohet me legjislacionin e vendit amë) si dhe miratimi zyrtar nga organet përgjegjëse të kompanisë së ndërmjetësimit. Në dokumentet e aplikuesve të jashtëm duhet të sjellët dhe statuti i kompanisë së jashtme amë së bashku me raportet financiare të kompanisë amë; [Origjinal]
- Dokumentet e kërkuar në formularin për aplikim dhe informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja. [Origjinal]

8. Licencë për Kompani të Sigurimeve - Licencë për Sigurues

Të gjeturat kryesore

Baza ligjore për lëshimin e lejes/licencës:

Dispozitat ligjore të Ligjit për Sigurimet si dhe aktet nënligjore të BQK-së, përbëjnë bazën kryesore të legjislacionit me anë të së cilës është bërë rregullimi i fushës së sigurimeve në aspektin e lëshimit të licencave për personat fizik dhe juridik. Ligji për sigurimet në nenin 4, paragrafi 2, përcakton përgjegjësinë ekskluzive të BQK-së për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e siguruesve dhe ndërmjetësuesve të sigurimit, si dhe shprehimisht thekson se vetëm personat që janë të licencuar dhe kanë aprovim të vlefshëm për ndërmjetësimin e sigurimeve, mund të merren me këtë veprimitari (neni 5, par.1).

Sigurues, sipas përkufizimit në Ligjin për Sigurimet, nënkuftohet personi juridik i licencuar për të ushtruar veprimitari të sigurimeve sipas përcaktiveve të këtij ligji. Ashtu siç theksuanë më lartë, baza ligjore për licencim është përcaktuar në Ligjin për Sigurimet, respektivisht, duke filluar në nenin 10, apo fazën e parë të paraqitjes së kërkesës për licencë, për të vazhduar me nenin 11 i cili përcakton kushtet që duhet plotësuar kërkesa për miratim paraprak si dhe kushtet që duhet plotësuar për miratim paraprak të kërkesës për licencë lidhur me një subjekt të varur ose degë të siguruesit të jashtëm dhe në fund neni 12, si dispozitë e cila përmbylli procedurën e aplikimit për licencë me dhënien e licencës nga BQK-ja, pasi që e njëjtë të ketë vlerësuar se janë plotësuar kushtet e licencimit sipas këtij ligji.

Veprimitaria për të cilën lëshohet leja/licenca:

Veprimitaria kryesore për të cilën lëshohet kjo licencë është për të zhvilluar veprimitari të sigurimit të jo-jetës, për klasë të veçanta të sigurimit, në përputhje me nenin 7 të Ligjit për Sigurime, veprimitari të sigurimit të jetës, veçmas ose për të gjitha klasat e sigurimit e përcaktuara me nenin 8 të Ligjit për Sigurime dhe veprimitari të risigurimit, për të gjitha klasat e veprimtarisë së sigurimit.

Vlefshmëria kohore e lejes/licencës:

Licenca e lëshuar nga BQK-ja është e pakufizuar në kohë dhe nuk është e transferueshme.

Pagesa për pajisjen me leje/licencë:

Tarifa e regjistrimit: Pagesë për marrjen e licencës 10,000.00 €

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Formulari i aplikimit; [Origjinal]
- Dokumentin që vërteton posedimin e kapitalit të autorizuar dhe të zotuar të siguruesit të propozuar ose degës së siguruesit të jashtëm si dhe fondit shtesë për shpenzimet fillestare sipas përcaktimeve të nenit 19 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Sigurimet dhe Rregullores për Licencimin e Siguruesve dhe Degëve të Siguruesve të Jashtëm, duke përfshirë të dhënët mbi burimin e kapitalit dhe fondit shtesë; [Origjinal]
- Listën e aksionarëve, llojin e aksioneve, të dhënët për vlerën nominale të aksioneve, përqindjen e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar dhe personat apo palët e mundshme të ndërlidhura; [Origjinal]
- Raportet individuale për drejtorët dhe menaxherët e lartë të propozuar të sigurimeve; [Origjinal]
- Planin e biznesit që përfshin, ndër të tjera, strukturën organizative të siguruesit të propozuar ose siguruesit të jashtëm; [Origjinal]
- Llojin e parashikuar të veprimtarive siguruese dhe pasqyrat e parashikuara financiare për tri (3) vite; [Origjinal]
- Të dhënët personale, historikun afarist dhe profesional për dhjetë vitet e fundit dhe pasqyrat financiare të audituara për tri (3) vitet e fundit (nëse ekzistojnë) të çdo aksionari kryesor që mbajnë dhjetë përqind (10%) a më shumë të aksioneve të siguruesit të propozuar; [Origjinal]
- Për çdo drejtor ose menaxher të lartë apo aksionar kryesor të siguruesit të propozuar ose të degës së siguruesit të jashtëm, dëshminë zyrtare nga Gjykata që shpalos çdo dënim për vepra penale, dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organi tjetër sipërmarrës (si pasqyra të ATK-së dhe Trustit Pensional), që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese, nëse ka; [Origjinal]
- Draft-kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën ka kërkuar të licencohet; [Origjinal]
- Plan-programin për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit; [Origjinal]
- Në çdo rast kur paraqitësi i kérkesës është një sigurues i jashtëm, që propozon themelimin e një kompanie varëse të sigurimeve ose të një dege në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të veprimtarive të propozuara në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje të konsoliduar të veprimtarisë ndaj siguruesit të jashtëm përfshirë kompaninë varëse të sigurimeve apo degën e siguruesit të jashtëm, që kërkon të licencohet në Kosovë; [Origjinal]
- Dëshminë e pagesës së tarifës për licencim; [Origjinal]
- Dokumentet e kérkuara në formularin për aplikim dhe informacione tjera shtesë të cilat mund të konsiderohen si të duhura nga BQK-ja. [Origjinal]

Rekomandimet kryesore:

1. Të konsiderohet aplikimi në procedurë elektronike për aplikim dhe shqyrtim të licencave, në ato raste kur mund të menaxhohet një proces i tillë (jo domosdoshmërish tek të gjitha);
2. Të zbatohet parimi i ndihmës administrative dhe i zhvillimit të procedurës sipas detyrës zyrtare, në kuptim të verifikimit të disa dokumenteve që i posedojnë institucionet publike;
3. Publikimi në uebfaqe i një manuali të licencimit të Fondeve Pensionale;
4. Të zbatohet nënshkrimi i deklaratës nën betim nga aplikuesit, në mënyrë që të reduktohen një pjesë e dokumentacionit të kërkuar (plotësuar).